

# AKT - THEMELIM

## I

### SHOQËRISË TREGTARE “ ENVOPOOL ” SH.P.K

Në Elbasan, sot më datë 06/08/2024 (dymijë e njezet e katër) unë e nënshkruara ;

- 1- Ana Kürüm, e bija e Pëllumb dhe Elisabeta , e datëlindjes 31/07/1989, lindur në Elbasan dhe banues në Elbasan në Lagjen 5 Maji, Pallatin 749 , Ap 16, madhor e me zotësi të plotë për të kryer veprime juridike, pajisur me nr personal ID **195731104L** dhe me nr letërnjoftimi **039151054** lëshuar më datë 13.10.2023.

Bazuar në ligjin nr 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” , ligjin nr 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”; në vendimin nr 31, datë 06.06.2007, të Bankës së Shqipërisë “Për licensimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikqyrjen e zyrave të Këmbimit Valutor”, si dhe ndryshimeve përkatëse dhe në ligjet e tjera që lidhen me veprimtarinë tregtare e bankare në Republikën e Shqipërisë, me vullnetin tim të lirë , vendosa të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar si më poshtë vijon :

#### NENI 1

Shoqëria emërtohet “ ENVOPOOL ” SH.P.K

Shoqëria është person juridik dhe do ta zhvillojë aktivitetin e sajë bazuar në Aktin e themelimit dhe statutit të sajë si dhe legjislacionit shqiptarë.

#### NENI 2

Shoqëria e ka selinë e sajë në qytetin e Elbasanit , Lagja “5 Maji” zona kadastrale 8525 me nr pasurie 26/198+1-16, pallati 749, AP 16.

Shoqëria mund të krijojë degë të tjera dhe të zhvillojë veprimtarinë e sajë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit për shoqëritë tregtare.

#### NENI 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë me një afat të papërcaktuar, duke filluar nga data e fitimit të personalitetit juridik të sajë .

Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe sipas kushteve të përcaktuara në aktin e themelimit dhe statutin e saj.

#### NENI 4

Shoqëria “ ENVOPOOL ” SH.P.K ka për objekt të veprimtarisë së sajë:

- 1- Import-Export, tregtim me shumicë dhe pakë i artikujve te ndryshëm industriale, artikujve dhe paisjeve per pishina si pompa , filtra , makineri dhe aksesore te ndryshem .

2-Trajtimin e ujrave te ndotura te çdo lloji, si ato urbane, industrial sipas degëve të veçanta të industrisë, ujrave nga kullimi i tokave bujqësore, pastrime të mbetjeve të ndryshme urbane e industriale, Instalimin dhe mirmbajtjen e impjanteve të trajtimit të ujrave të rrjedhshëm, filtrimin dhe pastrimin ujrave , baltrave etj.

Monitorimin dhe studimin e kushteve mjedisore teknikave të procesit të trajtimit sipas kushteve ligjore, trajnime të ndryshme stafi qe merren me perdorimin e impjanteve etj.

#### NENI 5

Kapitali regjistruar i shoqërisë është **100.000 Lekë (Njëqind mijë lekë)**,  
i ndarë në 1 kuotë;

me vlerë nominale 100.000 lekë sejcila kuotë.

Kjo Vlerë e kapitalit të regjistruar do të depozitohet pranë një banke të nivelit të dytë.

Kuotat e kapitalit të shoqërisë zotërohen nga ortaku i vtëm i shoqërisë z/ Ana Kürüm me 100 %

#### NENI 6

Organet drejtuese të shoqërisë janë Asambleja e përgjithshme dhe Administratori.

-Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së përgjithshme thirret të paktën 1 herë ne vit me kërkesën e Administratorit, i cili njofton me shkrim Ortakët e shoqërisë për, vendin , datën, orën, rendin e ditës se mbledhjes dhe jo më vonë se 7 ditë përpara datës së mbledhjes.

Administratori emërtohet nga Asambleja e Përgjithshme ne mbledhjen e zakonshme :  
Administartor i Shoqërise emërohet z/ Ana Kürüm, lindur në Elbasan më dt 31/07/1989 dhe banues ne Elbasan ne lagjen, Lagjen 5 Maji, Pallatin 749 , Ap 16 i pajisur me nr personal **195731104L** me kohëzgjatje të mandatit për **5 vjet**.

#### NENI 7

Përsa nuk është parashikuar në këtë statut dhe në aktin e themelimit bazuar ne ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe ligjin nr 9723 dt.03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe në ligjet e tjera që lidhen me veprimtarinë tregtare në Republikën e Shqipërisë.

Ky akt themelimi u redaktua në tre kopje me nga dy fletë secila.

#### PËR SHOQËRINË TREGTARE

**“ ENVOPOOL ” SH.P.K**

**Ortaku themelues**

**ANA KÜRÜM**

*Ana Kürüm*  
